



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:017253
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05698946

C.nr.209/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z.R. nga fshati T.-P., të cilin e përfaqëson Muhamet Ibraj avokat ne Peje, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “PRISIG” me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensim i dëmit nga auto përgjegjësia, vlera e kontestit 1,291 euro, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor dhe publike, në prezencën e të autorizuarve të ndërgjyqësve, me datë 29.04.2024 mori kurse me datë 17.05.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

- I. APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit Z.R. nga fshati T.-P.
- II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve PRISIG Sh. A. me seli në Prishtinë, që paditësit Z.R. në emër të kompensimit të dëmit material për dëmin në veturë në aksidentin e ndodhur me datë 31.12.2020, t’ia paguajë shumën prej 1,291 euro me kamatë ligjore në lartësi prej 8% të llogaritur nga data 28.01.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET pala e paditur që paditësit të i’ a kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 679 euro në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim

I. Historiku i procedurës

Paditësi Z.R. përmes të autorizuarit të tij, me datën 28.01.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “PRISIG”, me bazë juridike kompensim dëmi nga Autopërgjegjësia të cilën padi me anë të parashtrësës së datës 11.04.2024 e ka ndryshuar, dhe gjykata e ka lejuar ndryshimin me aktvendimin procedural të datës 29.04.2024, në vlerë të kontestit në shumë prej 1,291.00 euro.

II. Pretendimet e ndërgjyqësve

Paditësi, në padi ka deklaruar se me datën 31.12.2020 rreth orës 15:45 ka ndodhur një aksident komunikacioni, ku deri te aksidenti ka ardhur kur vetura “A” e markës R. ngjyrë e kaltër me targa 0..... te cilën e drejtonte S.K. e cila po lëvizte ne rr. “Konferenca e Bujani” e cila ne mënyre te pasigurt nga shiriti i djathte kthehet ne anën e majte duke ja ndërprere rrugën veturës “B” te markës A.... me targa me ngjyrë te hirit te cilën e drejtonte Z.R. i cili ishte duke lëvizur ne drejtimin e njëjte ne shiritin e majt , me çka vjen deri te aksidenti. Me këtë rast vetura “B” ne pjesën e përparme i shkakton dëme te konsiderueshme materiale, ashtu që ka propozuar që të DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “PRISIG” me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material për dëmin në veturë në aksidentin e shkaktuar me datë 31.12.2020, t’ia paguajë shumën prej 1291 euro me kamatë ligjore në lartësi prej 8% me kamatë të llogaritur nga data 28.01.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Përgjatë seancave dhe në fjalën përfundimtarë ka deklaruar se qëndron prapa padisë, kërkesës se saj duke propozuar që gjykata të aprovojë kërkesëpadinë sipas parashtrësës së precizuar në bazë të ekspertizës së ekspertit Bajram Latifi.

Shpenzimet i ka kërkuar në lartësi prej 887 Euro.

Gjykata, palës së paditur, me datën 05.10.2023, i ka dorëzuar aktvendimin për përgjigje në padi, ku e paditura këtë aktvendim e ka pranuar me datën 17.10.2023 dhe ne përgjigje në padi nuk e kanë kontestuar bazën juridike te kërkesëpadisë por lartësinë e saj. Në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur ka deklaruar se mbesim ne tërësi pranë përgjigjes ne padi duke mos e kontestuar edhe me tutje bazën juridike te kërkesëpadisë por vetëm lartësinë e saj, ndërsa ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim ne tërësi pranë

përgjigjes ne padi dhe deklarimeve nga seancat, e duke e kundërshtuar precizimin e kërkesëpadisë dhe ekspertizat si jashtëzakonisht të larta, kurse sa i përket shpenzimeve të procedurës, nga gjykata kanë kërkuar që të ketë parasysh suksesin e paditësit në procedurë.

Shpenzimet e procedurës nuk i kanë kërkuar.

III. Provat e administruara, vlerësimi i provave dhe baza ligjore

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat si në vijim: Raporti i aksidentit 2020-DA-... i dt. 31.12.2020, Njoftimi lidhur me kërkesat për kompensim demi i dt. 21.01.2021 i KS-PRISIG Sh.A, Procesverbali mbi demet ne automjet përpiluar nga Prisig Sh.A ne muajin janar 2021, Polisa e sigurimit kufitar e dt. 19.12.2020, Kopja e lejes se njoftimit për Z.R., Ekspertiza e makinerisë e dt. 20.02.2024 e përpiluar nga eksperti Afrim Kuqi, Certificate e regjistrimit te automjetit ne emër te Z.R. e përkthyer nga gjuha gjermane, Ekspertiza e makinerisë e dt. 07.03.2024 e përpiluar nga eksperti Bajram Latifi.

IV. Vlerësimi juridik dhe faktik i gjykatës:

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 7 dhe 8 të LPK-së, e aprovoi tërësisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjatë procedurës gjyqësore rezultojë të mos jetë kontestues fakti se shkaktari i aksidentit të komunikacionit, nga ka rrjedhur edhe dëmi, të ketë qenë i siguruar tek e paditura, me çka nuk ishte kontestuese baza e juridike e kërkesëpadisë, ku pala e paditur nuk e kontestoj asnjëherë bazën e kërkesëpadisë. Në këtë drejtim, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e këtij fakti.

Kontestuese gjatë tërë kësaj procedure gjyqësore, ishte lartësia e kërkesëpadisë, ku përfaqësuesit e palëve ndërgjyqjese, kishin pikëpamje të ndryshme në këtë aspekt.

Nga raporti i Policisë i 31.12.2020 me numër DR-.-DA-197, gjykata vërtetoi faktin se deri tek aksidenti në fjalë i datës 31.12.2020, kishte ardhur derisa drejtuesi e automjetit (A) S.K. gjate kthimit majtas ne mënyre te pasigurt nga shiriti i djathte ne te majte , ne rrugën me dy shirita ,

drejtimi i njëjte ia ndërpret qarkullimin veturës “B” Z.R. e cila ishte në lëvizje në shiritin e majte, drejtim i njëjte. Aksidenti është vetëm me dëm material, pa lëndime.

Nga procesverbali mbi demet në automjetet përpiluar nga Prisiq Sh.A në muajin janar 2021, gjykata vërtetoi faktin se në aksidentin e trafikut dt. 31.12.2020 në veturën e palës paditëse janë shkaktuar dëme materiale e të cilat për se afërmi janë evidentuar në këtë procesverbal, e i cili procesverbal lidhur me dëmet materiale në veturën e paditësit, më pas ka shërbyer si prove për përpilimin e ekspertizës së makinerisë, sepse procesverbali i tillë është përpiluar pas aksidentit të ndodhur nga pala e paditur.

Me parashtesën për realizimin e dëmit drejtuar të paditurës gjykata vërtetoi faktin se paditësi i ishte drejtuar për kompensim të paditurës, kurse me ofertën e të paditurës e dt.21.01.2021, gjykata vërtetoi faktin se e paditura i ishte përgjigjur kërkesës së tillë dhe kishte ofruar për kompensim shumë prej 400.00 euro.

Përmes Certifikatës së regjistrimit të automjetit në emër të Z.R.–me të cilën vërtetohet fakti se Z.R. është pronar i automjetit të aksidentuar me numër të targave ... të lëshuara nga shteti Gjerman, veturë e tipit A... i prodhuar me 04.08.2011 - dizel, e cila provë materiale gjykatës i ka shërbyer sic u tha për të provuar se paditësi ka qenë pronar i automjetit të aksidentuar, e nga edhe të njëjtë si pronar i sendit i lindur drejtë për kompensim, apo thënë në terma juridik, vërtetohet legjitimiteti real aktiv i palës paditëse.

Referuar provave të sipërcekura, gjykata u’ka falur në tërësi besimin, sepse të njëjtat nuk ishin kontestuar nga palët në procedurë, e për më tepër të njëjtat ishin të lëshuara nga organet shtetërore, respektivisht nga Policia e Kosovës, ku procesverbali paraqesin raportin zyrtarë, si të tilla i kanë shërbyer gjykatës për vërtetim të fakteve të cilat janë paraqitur dhe si vendimtare në këtë procedurë, si për përcaktimin e bazës së kërkesëpadisë e poashtu dhe për përcaktimin e lartësisë së kontestit.

Me qëllim të vërtetimit të përcaktimit të dëmit material në këtë aksident të trafikut, gjykata sipas propozimit të palës paditëse, ka nxjerrë provën përmes ekspertizës së makinerisë. Eksperti Afrim Kuqi me ekspertizën e datës 20.02.2024 ka konstatuar se automjeti i palës paditëse i tipit A... si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka pësuar shkallë të vogël të dëmit, ashtu që në bazë të provave që ka pasë para vetes, ka konstatuar se riparimi i automjetit në ekspertizë, teknikisht është lehtë

të arrihet dhe sipas mendimit të tij, riparimi profesional, garanton kualitet, cilësi dhe funksionalitet solid në aspektin e përballimit të rezistencës statike, dinamike dhe aero dinamike të automjetit të lëvizje, andaj automjetit llogaritet si dëm i riparueshëm. Si përfundim, kur ka llogaritur orët e punës dhe pjesët e dëmtuara për riparim dhe ndërrim si dhe për lyerje, ka ardhur në përfundim se dëmi total në veturë është në lartësi prej 1208,89 euro, kur 763.89 euro janë pjesë për ndërrim dhe riparim, 220 euro lyerje dhe 224 euro orë pune.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare e bazuar në nenin 362 të LPK-së, ka ftuar ekspertin për sqarime në seancë, i cili në seancën e datë 18.03.2024 ka deklaruar se: qëndroj ne tërësi pranë ekspertizës së përpiluar me dt 20.02.2024, kurse duke u përgjigje në pyetjet e të autorizuarit të palës së paditur ka deklaruar se veturën nuk e ka inspektuar sepse nuk i është kërkuar si detyrë, kurse pasi që ka marrë lëndën për ekspertim të automjetit A..., në shkresat e lendes kane munguar fotografi te qarta te automjeti te dëmtuar, ku përmes komunikimit me palën e paditur KS-Prisig kam siguruar fotografi te kualitetit te qarte te automjetit te dëmtuar dhe se ekspertimi i mundshëm i automjetit – ekspertimi fizik nuk do të ndikonte në vlerësimin e dhënë me dt.20.02.2024. sa i përket pjesëve të dëmtuara, është bazuar në procesverbalin e dëmit në automjet si dhe fotografitë e siguruar nga pala e paditur, kurse për përcaktimin e çmimit për pjesët e dëmtuara jam bazuar ne katalogun e automjetit “tecdoc catalogue” ku varësisht nga pjesa e te dhënave te automjetit del edhe çmimi i blerjes se pjesës, ku çmimet e dhëna për riparim te automjetit janë çmime te ditëve te sotme. Nga katalogu merret dhe caktohet secila pjesë veç e veç, ku katalogu jep numrin e pjesës apo kodin e ku përmes saj me kërkim në tregun online, jepet saktë se sa kushton një pjesë, e nuk ka rëndësi nëse aplikohet apo jo në Kosovë, sepse përcakton vetëm çmimin e pjesës. Lidhur me pyetjen e të autorizuarës së palës së paditur, se çmimet e marra për pjesët e veturës a janë çmimet për vitin kur ka ndodhë aksidenti apo ato që variojnë sot në treg, eksperti është përgjigjur se këto çmime janë të ditëve të sotme, e po të ishte dhënë si detyrë që të llogariteshin sipas çmimeve të kohës së aksidentit, do të kishte qenë vështirë dhe jo reale.

Gjykata ekspertizës së ekspertit Afrim Kuqi nuk i ka falur besimin, pasi që e njëjta është përpiluar duke marrë për bazë vlerën e çmimit të tregut në momentin e përpilimit të ekspertizës, pra në vitin 2024, mirëpo eksperti ka deklaruar se një mendim lidhur me dëmet në veturë për vitin kur ka ndodhë aksidenti, nuk do të kishte mundësi që ta bënte.

I autorizuari i palës së paditur, marrë parasysh se eksperti nuk ka përpiluar ekspertizën bazuar në çmimet kur ka ndodhë aksidenti, ka propozuar qe te behet përsëri ekspertiza e makinerisë qe

te bëhet llogaritja e demit të automjetit duke u bazuar në çmimorën e pjesëve për vitin kur ka ndodhur aksidenti si dhe vlerësimin e demit të beje duke u bazuar në vlerat të cilat variojnë në tregun e Kosovës.

Gjykata ka aprovuar një propozim të tillë dhe për ekspert ka caktuar ekspertin Bajram Latifi nga Prishtina, i cili me ekspertizën e datës 27.03.2024 i ka konstatuar se dëmi i shkaktuar në automjet konsiderohet dëm parcial, riparimi i demit të shkaktuar si pasojë e aksidentit ka qenë teknikisht i mundur dhe i arsyeshëm. Ekspertizën e tij e ka punuar në dy variante, duke u bazuar në çmimorën e tregut në vitin 2021 kur ka ndodhur aksidenti dhe në atë të vitit 2024 kur është përpiluar ekspertiza. Çmimet e pjesëve janë marre duke hulumtuar tregun e Kosovës sipas kohës së aksidentit dhe kohës së përpilimit të kësaj ekspertize, konkretisht në servisën “O... dhe “O..”-V.. Gjate kalkulimit të demit, vërehet se çmimi i pjesëve të dëmtuara është më i ulët se në kohën e ndodhjes së aksidentit, ndërsa ora e punës, ngjyra dhe materiali i imët janë më të larta, lartësia e demit në automjet në kohën e ndodhjes së demit është 1,291 euro ndërsa lartësia e demit në automjet në kohën e përpilimit të ekspertizës është 1,217 euro.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare e bazuar në nenin 362 të LPK-së, ka ftuar ekspertin për sqarime në seancë, i cili në seancën e datë 29.04.2024 ka deklaruar se: qëndroj në tërësi pranë ekspertizës së përpiluar me datën 27.03.2024, kurse në pyetjen e gjykatës ka deklaruar se ora e punës lidhur me automjetin dallon varësisht nga tipi dhe lloji i automjetit si dhe varësisht nga viti i prodhimit apo specifikat teknike që mund të ketë një automjet.

Gjykata kësaj ekspertize i ka falur besimin në tërësi, pasi që e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale nga ana e ekspertit, ka paraqitur mendimin lidhur me dëmet në të dy variantet, në kohën e aksidentit dhe kohën e përpilimit të ekspertizës. Ka treguar mënyrën se si ka ardhur deri tek llogaritja e dëmeve në mënyrë profesionale, e cila për gjykatën është paraqitë si ekspertizë e plotë dhe ka sqaruar mjaftueshëm dëmet në veturën e palës paditëse.

Tutje, palët në procedurë, nuk kishin ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë tjetër të makinerisë. Gjykata edhe pse para vetes kishte dy ekspertiza të makinerisë, pasi që nuk kishte propozime nga palët për një ekspertizë të tretë, ka vlerësuar se nuk ka nevojë që të nxjerrët një ekspertizë e tretë, pasi që dallimet e ekspertëve në raportet e tyre janë të vogla dhe nuk dallojnë esencialisht, ashtu që gjykata ka vendosë që si të bazuar të merr ekspertizën e ekspertit Latifi si profesionale

dhe të plotë e përmes së cilës është përcaktuar fakti vendimtar në këtë çështje, lartësia e dëmit në automjet.

Në këtë rast, gjykata vlerëson se ligj i aplikueshëm është Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, i cili rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material). Me nenin 136 par.1 të LMD-së parashihet se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij: kurse me nenin 159 i LMD-së, par.1 thotë: “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”. Me nenin 137 të LMD-së përcaktohet se: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Prandaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material, nenin 169 par. 1, 2, 3, dhe 4 të LMD-së, personi përgjegjës ka për detyrë që ta rivendose gjendjes e cila ka qene para se te shkaktohet dëmi, nëse nuk mënjanohet plotësisht dëmi, personi përgjegjës ka për detyrë që pjesën tjetër të jap shpërblim në të holla, kur rivendosja në gjendje të mëparshme nuk është e mundur gjykata cakton që të paguaj të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla dhe gjykata do të gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme, kurse bazuar në nenin 170 të LMD-së, detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur për pagesë që nga momenti i shkakimit të dëmit.

Gjykata vlerëson se shumën e kompensimit të aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është adekuate, duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit në veturë dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, është reale, pasi që dëmi material në veturë është dëm i matshëm dhe është provuar me ekspertizën e makinës së ekspertit Bajram Latifi.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar tërësisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësit i takon edhe kamatëvonesa, gjykata lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8 %, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi të kryesor, edhe kamatën.” Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e llogaritur nga data e ngritjes së padisë me datë 28.01.2021, sepse bazuar në nenin 170 të LMD-së “Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet

se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”. Sipas kësaj, kamata për dëmin material fillon të rrjedhë që nga momenti i parashtrimit të padisë për kompensimin e dëmit. Gjykata vendosi për kamatën prej 8% për faktin se pala e paditur, i ishte përgjigjur me ofertë kërkesës së palës paditëse për kompensimin e dëmit, ku i kishte ofruar si kompensim shumë prej 400.00 euro, e në këtë rast nuk aplikohet kamata prej 12%.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, si fakt vendimtar me të cilën u përcaktua rrjedha e procedurës së kësaj çështje, fillimisht ishte fakti se pala e paditur nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë, ashtu që gjykatës i kishte mbetur për të vërtetuar vetëm lartësinë, kur për vërtetimin e lartësisë për dëmin material, si provë vendimtare paraqitet ekspertiza e makinerisë e ekspertit Bajram Latifi e përmes së njëjtës gjykata ka ardhur në përfundim se cili duhet të jetë kompensimi i drejtë për paditësin.

Gjykata i vlerësoj dhe pretendimet e palës së paditur, por që të njëjtat nuk patën ndonjë rol për vendosje ndryshe të gjykatës, pasi që në përgjithësi pala e paditur, tërë kontestimin e saj e kishte në drejtim të lartësisë së kontestit. Lidhur me vërejtjet për ekspertiza, gjykata i kishte dhënë mundësinë që të jepte propozimet, kurse pas nxjerrjes së ekspertizës së dytë, nuk kishin ndonjë propozim tjetër konkret, andaj gjykata e gjendur para një sërë provash materiale të cilat i ka administruar, ka vlerësuar se kompensimi i akorduar si në dispozitiv, i përgjigjjet më së miri apo thënë ndryshe, është kompensimi adekuat për paditësin për dëmin material në veturë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së dhe atë si në vijim: për përpilimin e padisë 104€, shpenzimet për ekspertizë të makinerisë 150€, për 3 seanca nga 135€, si dhe taksën për padi 20.00 €, apo shuma e përgjithshme 679, kurse pjesa tjetër e shpenzimeve është e pa bazuar, e të cilat shpenzime janë llogaritur për vlerën e kontestit deri në 10,000 euro, sipas tarifës zyrtare dhe rregullore së OAK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura dhe bazuar në nenin 142 par.1 dhe 2, 143.1 të LPK-së nenit 136 par.1, 137, 159 par.1, 169, 170, dhe nenit 382 të LMD-së dhe nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:017253, C.nr.209/21, Dt.17.05.2024

Gjyqtari:
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.